

Aragol® L40



ARAGOL® L40

INSEKTICID EMULSIV
VEPRIM KONTAKTI

- Veprim kontakti dhe të brendshëm
- Spektër të gjerë veprimi
- Shumë efikas kundër mizës së ullirit dhe qershisë



MIZA E QERSHISË

Miza e qershisë është dëmtues i përhapur në vendin tonë. Larva e këtij dëmtuesi ose, siç e quan populli, krimbi i qershisë prek kryesisht qershitë me pjekje gjysëm të vonshme dhe të vonshme. Në vite të veçanta prekja e frutave arrin deri në masën 80% të tyre. Frutat e kimbura humbasin vlerën tregtare. Ato errësohen në vendin e prekur. Miza trupin e ka me ngjyrë të zezë të ndritshme dhe ka gjatësi 3-5 mm. Koka, mburoja dhe këmbet kanë ngjyrë të verdhë të hapur.



(*Rhagoletis cerasi* .L.)

MIZA ULLIRIT

Është nga dëmtuesit më të rrezikshëm të ullirit, mjaft i përhapur në vendin tonë dhe shpesh herë dëmton deri 80 % të prodhimit. Dëmi: Larvat ushqehen vetëm me tulin e kokrrave të ullinjve nga ku ka marrë edhe emrin krimbi ose miza e ullirit. Insekti i rritur i përngjet mizës së shtëpisë, por është më i shkathët dhe më i vogël. Trupi është i gjatë 4-5 mm, kurse me krahë të hapur 10-12 mm.



(*Bactrocera oleae* Gmel)

MORRI I GJELBËR I MOLLËS

Është morri më i përhapur dhe më dëmprurës në mollë. Ai prek edhe mushmollën vollëzën, dardhën, ftoin dhe trëndafilin. Kolonitë me dëmtues zakonisht gjenden mbi gjethet dhe lastarët e rinj, nga të cilat thithin lëndët ushqyese. Femra pa krahë është 1.5-2 mm e gjatë, ka ngjyrë të gjelbër, me sifone dhe kanda me ngjyrë të zezë. Antenat janë të verdha pak më të shkurtëra se gjatësia e trupit. Femra me krahë është e ngjashme me atë pa krahë, vetëm se koka dhe kraharori i saj ka ngjyrë kafe në të zezë. Gjatësia e trupit është 2-2.5 mm.



(*Aphis pomi*)

ARAGOL® L40

Përbërja	Dimetoat puro 38g (=407 g/l)
Formulimi	Koncentrat i emulsionueshëm (EC)
Grupimi	IRAC 4A
N.regjistrimit	16. Datë 18. 03. 2011
Konfeksioni	15ml, 30, 1Lt

Insekticid i emulsionueshëm me veprim kontakti dhe të brendshëm

KARAKTERISTIKAT

Insekticid i emulsionueshëm për mbrojtjen e Pemëve frutore farore, Agrumeve, Qershisë, Ullirit, Sallatës, Angjinare, Domate, Patëllxhan, Panxharsheqeri, Drithëra, Bimë lulore, Bimë dekorative.



KULTURAT	DËMTUESI	MËNYRA PËRDORIMIT	KARENCA
ULLINJ (maksimumi 2 ndërhyrje)	Miza e ullirit (Dacus = Bactrocera oleae)	këshillohet të kryhen 2 trajtime si mëposhtë në varësi të varieteteve me dozë 150 ml/hl: Ullinj me pjekje të hershme: I-Trajtoni në Gusht-Shtator II-Trajtoni në fillim të Tetorit Ullinj me pjekje të vonë: I-Trajtoni në mesin e Shtatorit II-Trajtoni në mesin e Tetorit	35 ditë
	Tenja (Prays oleellus)	100-150 ml/hl	
POMACEE (Mollë, Dardhë (jo në prodhim))	Morri i gjelbër i mollës (Aphis pomi), Morri miellor i dardhës (Dysaphis pyri) Morri i përgjakshëm (Eriosoma lanigerium) Pleshti i mollës (Psylla mali) Pleshti i dardhës (Psylla sp.) Tripsset	75 ml/hL	20 ditë
AGRUME (jo në prodhim)	Morrat (Toxoptera aurantii etj.), Tripsi i serave (Heliothrips haemorrhoidalis), Dipterët, Lepidopterët	100-150 ml/hL	20 ditë
QERSHI	Miza e qershisë (Rhagoletis cerasi)	trajtoni me fillimin e ndryshimit të ngjyrës së kokrrës me perqëndrim 100 ml/hl)	
PJESHKË	Miza e frutave	125 ml/hl Trajtimi bëhet kur frutat kanë filluar të marrin ngjyrë.	20 ditë
KAJSI		100 ml/hl Trajtimi bëhet kur frutat kanë filluar të marrin ngjyrë.	
HARDHI	Dipterët, Koleopterët	100-150 ml/hL	20 ditë

KULTURAT	DËMTUESI	MËNYRA PËRDORIMIT	KARENCA
PATATE	Morrat, Tripsset, Lepidopterët, Buburreci i patates (Leptinotarsa decemlineata)	100-150 ml/hl:	20 ditë
SALLATË, DOMATE, PATËLLXHAN (vetëm në fushë) ANGJINARE (pas vjejes së turioneve)	Morrat, adultët dhe larvat e Koleopterëve, Lepidopterët, Dipterët	100-150 ml/hL	20 ditë
DRITHËRA	Lepidopterët, Dipterët, Koleopterët, Morrat, Cecidomidet	100-150 ml/hl:	35 ditë
DUHAN	Tripsi i duhanit (Thrips tabaci) Morrat, Lepidopterët, Koleopterët, Cecidomidet	100-150 ml/hL	20 ditë
PANXHAR-SHEQERI	Lepidopterët, Koleopterët, Morrat, Çimkat etj.	100-150 ml/hl)	20 ditë
BIMË DEKORATIVE DHE ZBUKURUESE	Lepidopterët, Dipterët, Koleopterët, Morrat, Himenopterët	100-150 ml/hl)	-